

Bibël për fëmijët
paraqet

Pashka e
Parë



Shkruar nga: Edward Hughes
Ilustruar nga: Janie Forest
Alastair Paterson
Adaptuar nga: Lyn Doerksen
Përkthyer nga: Arianit Iljazi
Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org


BFC
PO Box 3
Winnipeg, MB R3C 2G1
Canada

©2024 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.



Grauja qëndronte
anës së një kodre të
zhurmshme, sytë e
saj duke vështruar
lart një skenë të
tmershme. Biri i
saj po vdiste.
Kjo nënë ishte
Maria, dhe ajo po
qëndronte pranë
vendit ku Jezusi
po gozhdohej
në një kryq.





Si ndodhi e gjitha kjo?
Si mundej Jezusi te
përfundonte një jetë
aq të mrekullueshme, në
një mënyrë të
tmerrshme?
Si mundej
Perëndia të

lejonte Birin e Tij të
gozhdohej në kryq, dhe
të vdiste atje? A bëri
Jezusi ndonjë gabim, se
kush ishte ai vetë? A
dështoi Perëndia?





Jo Perëndia nuk
dështoi. Jezusi nuk
kishte bërë asnjë
gabim. Jezusi gjithnjë
e dinte se Ai do të
vritej nga njerëz të ligj.
Madje qysh kur Jezusi
ishte fëmijë, një burrë
i moshuar i quajtur
Simeon i kshte treguar
Marisë se trishtim do
të vinte.




Disa ditë përpara se Jezusi të vritej, një grua erdhi dhe derdhi vaj të parfumuar mbi këmbët e Tij. "Ajo po shpërdoron para", një dishepull u ankua. "Ajo ka bërë një punë të mirë", Jezusi tha. "Ajo e ka bërë për varrimin tim". Çfarë fjalë të çuditshme!



Pas kësaj, Juda, një nga
dymbëdhjetë dishepujt,
ra dakord ta tradhtonte
Jezusin tek krerët e
priftërinjve për 30
monedha argjendi.





Në festën Judease të Pashkëve, Jezusi pati darkën e fundit me dishepujt e Tij. Ai u tregoi atyre gjëra të mrekullueshme reth Perëndisë dhe premtimeve të Tij për ata që e duan Atë. Pastaj Jezusi dha bukë dhe një kupë për ata, për ta ndarë.

Këto ishin për ti kujtuar ata, që trupi dhe gjaku i Jezusit ishin dhënë për të sjellë faljen e mëkateve.



Atëherë Jezusi u tha miqve të Tij, se Ai do të tradhtohej dhe ata do vraponin tutje. "Unë nuk do të vrapoj tutje", këmbënguli Pjetri. "Përpara se gjeli të këndojë, ti do të më mohosh tre herë", i tha Jezusi.





Më vonë atë
natë, Jezusi shkoi
të lutej në Kopshtin
e Gjetsemanit.
Disheujt që ishin
me Të i zuri gjumi.
"O Ati im", Jezusi
u lut, "... Largoje
këtë kupë nga Unë.
Megjithatë, jo siç dua
unë, por siç do Ti".



Papritmas një grup
njerëzish u futën në
kopësht, të drejtuar
nga Juda. Jezusi nuk
rezistoi, por Pjetri i
preu veshin një burri.
Qetësisht, Jezusi
preku veshin e atij
burri, dhe e shëroi
atë. Jezusi e dinte
që arrestimi i Tij,
ishte pjesë e
vullnetit të
Perëndisë.



Turma e çoi Jezusin tek shtëpia e kryepriiftit.
Atje drejtuesit Judenj, thanë që Jezusi duhet
të vdiste. Aty pranë,
Pjetri qëndronte
anash zjarrit të
shërbetorëve
dhe vështronte.




Tre herë njerëzit hodhën sytë nga Pjetri dhe thanë, "Ti ishe me Jezusin!" Tre herë Pjetri e mohoi, pikërisht ashtu si Jezusi kishte thënë. Pjetri madje edhe mallkoi dhe u betua.



Kiki-Riki-ii


Pikërisht atëherë një gjel këndoi. Ishte si zëri i Perëndisë për Pjetrin. Duke kujtuar fjalët e Jezusit, Pjetri qau me hidhërim.






Edhe Judas i erdhi keq. Ai e dinte që Jezusi nuk ishte fajtor për ndonjë mëkat ose krim. Juda mori ti kthente 30 monedhat e argjendit, por priftërinjtë nuk donin ti merrnin mbrapsht.





Juda i hodhi
paratë poshtë,
doli jashtë dhe
vari veten.







Priftërinjtë e sollën
Jezusin përpara Pilatit,
qeveritarit Romak. Pilati
tha, "Unë nuk gjej gabim
tek ky njeri". Por
turma bëritste
vazhimisht,
"Kryqëzoje!
Kryqëzoje!"



Më në fund Pilati u dorëzua, dhe e dënoi Jezusin me vdekje në kryq. Ushtarët e goditën me grushta Jezusin, e pështynë në fytyrë, dhe e fshikulluan. Ata bënë një kurorë mizore me gjemba të gjatë e të mprehtë dhe ia ngjeshën Atij mbi krye. Pastaj ata e gozhduan Atë në një kryq të drunjtë që të vdiste.



Jezusi gjithmonë e dinte se do të vdiste në atë mënyrë. Ai dinte gjithashtu se vdekja e Tij do ti sillte falje mëkatarëve që besojnë në Atë. Dy kriminelë u kryqëzuan përkrah Jezusit. Njëri besoi në Jezusin dhe shkoi në parajsë. Tjetri nuk besoi.



Pas orësh vuajtje,
Jezusi tha, "U krye",
dhe vdiq. Puna e Tij
ishite përmbushur.
Miqtë e varrosën
Atë në një
varr privat.



Ushtarët romakë e
vulosën dhe ruanin
varrin. Tani asnjëri
nuk hynte dot më
brenda, as dilte
dot jashtë.



Nëse ky do të ishte
fundi i historisë, sa e
trishtueshme do të
ishte. Por Perëndia
bëri diçka të
mrekullueshme.




Jezusi
nuk qëndroi
i vdekur.



Herët në mëngjesin e ditës
së parë të javës, disa nga
dishepujt e Jezusit e
gjetën gurin të
rrokullisur tutje
varrit. Kur
ata vështruan
brenda, Jezusi
nuk ishte më
atje.




Një grua qëndroi duke qarë pranë
varrit. Jezusi i shfaq asaj!
Ajo nxitoi me gëzim të madh
t'ia tregonte dishepujve të
tjerë. "JEZUSI ËSHTË I
GJALLË! JEZUSI ËSHTË
RINGJALLUR
PREJ
SË



VDEKURISHI!"





Shpejt Jezusi erdhi tek dishepujt e Tij,
dhe u trgoi atyre duart e çpuara prej
gozhdëve. Ishte e vërtetë. JEZUSI
ISHTE I GJALLË SËRISH! Ai e fali Pjetrin
që e pati mohuar, dhe u tha dishepujve tu
tregojnë të gjithëve rreth Tij. Pastaj Ai
shkoi përsëri në Parajsë, prej nga ku kishte
ardhuar atë Krishtlindje të parë.



Pashka e Parë

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla


e marrë nga

Mateut 26-28, Llukës 22-24,
Gjonit 13-21


"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130





54



60



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëj atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

